03/04/2020

Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit: ‘Le të kemi, të dashur besimtarë, guximin e Abrahamit, dhe le të kërkojmë me këmbëngulje dhe durim që Zoti të zgjasë dorën e Tij njeridashëse mbi të gjithë ne.’



“Nuk do ta shkatërroj për hir të të dhjetëve” (Zan.18:32).

Të dashur besimtarë!

Ngjarjet që po jetojmë kohët e fundit, zjarret masive, tërmetet e fuqishme në vende të ndryshme dhe tani së fundmi përhapja e virusit Covid-19 në gjithë botën, ka bërë që të dëgjohen shumë zëra se po jetojmë në një kohë dhe periudhë apokaliptike.

Sado të vështira dhe të dhimbshme të jenë këto ditë, ndonëse Zoti Krisht në mësimet e Tij na ka bërë të ditur se askush nuk e di kur Ai do të vijë përsëri me

lavdi; “Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s’e di, as engjëjt e qiejve, por vetëm Ati im” (Mt.24:36), përsëri ne kemi shpresë dhe siguri të madhe në njeridashjen e Perëndisë tonë.

Fragmenti nga leximi i sotëm në librin e Zanafillës 18:20-33 na siguron për këtë shpresë. Në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë na tregohet sesi Zoti i zbulon Abrahamit se ka zbritur të shoh paudhësinë e dy qyteteve, të Sodomës dhe Gomorës dhe nëse është e vërtetë “britma e mëkatit që ka arritur te Ai”, ka për të shkatërruar këto dy qytete.

Abrahami si mik i Zotit merr guximin dhe i thotë që të mos i shkatërrojë këto dy qytete për hir të të drejtëve që mund të banojnë në to. Edhe kur Abrahami, nga 50 të drejtë, përmend 45, 30, 20 deri në dhjetë banorë, Zoti i premton se: “nuk do t’i shkatërroj për hir të të dhjetëve” qytetet. Pra Perëndia nuk do t’i shkatërronte këto qytete nëse në to do të gjendeshin akoma edhe dhjetë njerëz të drejtë. Por fatkeqësisht në këtë rast qyteti u shkatërrua, sepse në të u gjendën vetëm katër persona, Loti, gruaja e tij dhe dy vajzat e tij si të drejtë.

E përmendim këtë ngjarje, duke e lidhur me situatën e sotme, jo që të dëshpërohemi, por përkundrazi, të kemi shpresë të madhe sepse ne besojmë se në qytetin tonë, në vendin tonë, në botën tonë, ka me dhjetra, me qindra dhe mijëra njerëz të drejtë të besës. Dhe Zoti nuk do ta shkatërrojë qytetin, vendin dhe botën tonë, për hir të këtyre njerëzve të drejtë shpresëtarë.

Nuk duhet të plogështohemi, si profeti Ilia që thoshte: “kam mbetur vetëm unë dhe ata kërkojnë të më vrasin” (3Mb.19:10), se jemi të vetëm në këto ngjarje të vështira që po kalojmë, por le të kemi guxim dhe shpresë në fjalën e Zotit, “kam një tepricë prej shtatë mijë njerëzish” (3Mb.19:18).

Sigurisht nuk ulim vigjëlencën dhe nuk harrojmë fjalët e Shpëtimtarit; “rrini zgjuar” (Mt.24:42), “jini gati” (Mt.24:44), por edhe kemi sigurinë që me Perëndinë, për hir të besimit të njerëzve të drejtë, do ta kalojmë edhe këtë situatë. Lusim Zotin që të kalojmë sa më lehtë dhe me sa më pak dhimbje.

Le të kemi, të dashur besimtarë, guximin e Abrahamit, dhe le të kërkojmë me këmbëngulje dhe durim që Zoti të zgjasë dorën e Tij njeridashëse mbi të gjithë ne.

Kurajo, pra, se asgjë “nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jisu Krishtin, Zotin tonë” (Rom.8:39).

Perëndia ju bekoftë!
Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit

+Nikolla

— facebook.com/MitropoliaFier